



KUVENDI I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË SË VERIUT
INSTITUTI PARLAMENTAR

PROGRAM
për pjesëmarrje në punëtori

*për mësimdhënësit e shkollave të mesme
në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Përmbajtjet për këtë punëtori janë zhvilluar dhe realizuar nga Njësia për Edukim dhe Komunikim e Institutit Parlamentar të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Informacione të përgjithshme:

Instituti Parlamentar është njësi e veçantë organizative në Shërbimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut që funksionon si një qendër për hulumtim, edukim dhe informim, i themeluar mbi parimet e paanshmërisë, arritshmërisë dhe kredibilitetit.

Instituti Parlamentar, ndër të tjera, kryen aktivitete për edukim dhe informim të qytetarëve për punën dhe rolin e Kuvendit (në përputhje me qëllimin e tij strategjik për hapjen e Kuvendit ndaj publikut).

Në këtë drejtim, nga viti 2021, Instituti Parlamentar filloi me organizimin e punëtorive për mësimdhënësit e shkollave mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit, është planifikuar të organizohet një punëtori për këtë grup të caktuar. Aktiviteti është një program i veçantë i Njesisë për Edukim dhe Komunikim të Institutit Parlamentar që realizohet si një punëtori që zgjat pesë orë e gjysmë. Ky lloj i punëtorive u dedikohet mësimdhënësve të shkollave të mesme, që në kuadër të lëndëve mësimore ligjërojnë përmbajtje në lidhje me menaxhimin e shoqërisë, qytetarinë aktive dhe pushtetin në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Një lëndë e tillë në programet mësimore të shkollave të mesme profesionale është lëndë Arsimit qytetar, që mësohet në vitin e parë.

Përshkrimi i punëtorisë

Punëtorja është paramenduar të realizohet si një seminar në kohëzgjatje prej pesë orë e gjysmë. Punëtorinë është një përpjekje për të përfshirë aspektet e programit mësimor që lidhen me punën dhe rolin e Kuvendit në sistemin e ndarjes së pushtetit, me një fokus në zbatimin e tyre praktik. Në punëtori dominon një qasje interaktive, e cila përfshin pjesëmarrësit nëpërmjet pyetjeve dhe diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave.

Punëtorja fillon me vizitë të organizuar në pjesën solemne të ndërtesës së Kuvendit, që përfshin Sallën Maqedonia (Salla Plenare), sallën Boris Trajkovski, korridorin para Sallës së Kristaltë, Sallën e Kristaltë, Sallën e Komisionit Kushtetues, Dhomën e Ohrid dhe Strugës, Dhomën Përkujtimore të KAÇKM-së, Sallën e Drugdhendjes së thellë, Korridorin e portreteve dhe Sallën nën kupolën e madhe. Nëpërmjet vizitës, pjesëmarrësit kanë mundësinë që nga afër të njihen me hapësirën në të cilën punojnë deputetët në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Agjenda e punëtorisë përbëhet nga katër sesione tematike. Në sesionin e parë shqyrtohet nevoja për edukimin politik të rinjve dhe vendin e arsimit qytetar

më programin e ri mësimor që ishte pjesë e reformave të zbatuara. Qëllimi i këtij sesioni është të bëhet këmbim i përvojave midis mësimdhënësve (edukim politik formal) dhe përfaqësuesve të Institutit Parlamentar të cilët zbatojnë aktivitete të ndryshme edukative në formë të edukimit politik joformal.

Qëllimi i sesionit të dytë është që të njihen pjesëmarrësit me materialet e shumta informuese dhe edukative të përgatitura nga Instituti Parlamentar për tema të ndryshme që lidhen me demokracinë dhe punën e dhomës ligjvënëse. Nëpërmjet këtij sesioni, mësimdhënësve u ofrohen mundësi të përdorin këto materiale për të arritur një ndërveprim më të madh në mësimdhënie me qëllim për të lehtësuar procesin e afrimit të Kuvendit me nxënësit.

Në sesionin e tretën, pjesëmarrësve u prezantohen aktivitetet edukative të organizuara nga Instituti Parlamentar dhe të dedikuara për nxënësit e shkollave të mesme. Në këtë mënyrë, mësimdhënësit njihen me mundësitë për bashkëpunim në të ardhmen dhe përfshirjen në aktivitetet edukative të Institutit Parlamentar në kuadër të realizimit të programit mësimor.

Në kuadër të sesionit të fundit do të përfshihen edhe deputetë nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët janë anëtarë të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Sport. Gjatë seancës, pjesëmarrësit do të mund të diskutojnë me deputetët për programet e reja mësimore dhe për statusin dhe vendin e Arsimit qytetar në procesin arsimor. Në këtë mënyrë, nëpërmjet bisedës së drejtpërdrejtë, pjesëmarrësit do të kenë mundësi të njihen edhe me punën e deputetëve dhe rolin e Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Sport.

Të gjithë pjesëmarrësve në këtë punëtori do t'u jepet certifikatë për pjesëmarrje.

- Qëllimet e përgjithshme të punëtorisë:** Mësimdhënës të gatshëm t'i përgjigjen sfidës së mentorimit të suksesshëm të nxënësve në lidhje me rolin e Kuvendit në sistemin e ndarjes së pushtetit dhe konceptin e shoqërisë civile, kështu që popullata e re do të nxitet dhe përgatitet për kritikë dhe përfshirje shoqërore dhe politike.
- Numri i pjesëmarrësve:** Një mësimdhënës nga çdo shkollë. Në shkollat ku zhvillohet mësimi dygjuhësh lejohet pjesëmarrja e dy mësimdhënësve.
- Koha:** Një herë në vit
- Vendi:** Salla Boris Trajkovski në Kuvend
- Gjuha:** Gjuha maqedonase me përkthim në gjuhën shqipe
- Trainues:** Punëtorja do të realizohet nga trajnuesit e Njesisë për Edukim dhe Komunikim në Institutin Parlamentar.
- Shpenzime:** Pjesëmarrja në punëtori është falas dhe përfshin materiale edukative falas, ushqim dhe pije freskuese gjatë punëtorisë. Shpenzimet e transportit nga dhe deri në vendin e punëtorisë i mbulojnë vetë pjesëmarrësit.
- Mënyra e paraqitjes:** Me ftesë paraprake të Institutit Parlamentar, çdo shkollë që do të ftohet të merr pjesë, emëron nga një mësimdhënës që do të jetë pjesë e aktivitetit dhe paraqet të dhënat e tij/saj.
- Kontakti:** E-mail: parl.inst@sobranie.mk
tel: 02/3182 - 227

Qëllimet e përgjithshme të punëtorisë:

Në fund të punëtorisë, mësimdhënësit:

- do të njihen me hapësirën ku punojnë deputetët;
- do të kuptojnë mekanizmat nëpërmjet të cilave një qytetar mund të jetë aktiv në shoqëri;
- do të përgatiten për bartje me sukses të njohurisë për punën dhe rolin e Kuvendit në sistemin e ndarjes së pushtetit;
- do të njihen hollësisht me materialet edukative dhe informuese të Institutit Parlamentar dhe mënyrën se si të njëjtat të përdoren në drejtim të lehtësimit të procesit të afrimit të Kuvendit me nxënësit;
- do t'i dinë mundësitë për bashkëpunim të ardhshëm dhe do të përfshihen në aktivitetet e ardhshme edukative të Institutit Parlamentar për nxënësit e shkollave të mesme.
- do të kenë mundësi që t'ua përcjellin drejtpërdrejt përfaqësuesve të popullit përvojat e tyre dhe sfidat me të cilat përballen në mësimdhënie.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, punëtorja do t'i përfshijë këto **përmbajtje**:

Përmbajtje	Kohëzgjatja
Vizitë e organizuar në ndërtesën e Kuvendit	60 minuta
Edukimi politik joformal kundrejt atij formal (gjendjet, perspektivat dhe mundësitë për bashkëpunim)	60 minuta
Përdorimi i materialeve edukative dhe informuese të Institutit Parlamentar	15 minuta
Prezantimi i aktiviteteve edukative të Institutit Parlamentar për nxënësit e shkollave të mesme	30 minuta
Takim me deputetë - anëtarë të Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Sport	60 minuta
Vlerësimi i punëtorisë	15 minuta